



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 23, datë 04.03.2019

PËR
MARRJEN E MASËS ADMINISTRATIVE, NDAJ AGJENTIT NË SIGURIME PRANË
SHOQËRISË SË SIGURIMEVE “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SH.A., ZJ.
MAKBULE HOXHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 21) të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 199, pikës 6), të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, me datë 17.01.2019, u depozitua ankesa lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore të kryera nga agjenti i licencuar i shoqërisë “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a., zj. Makbule Hoxha, gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj të shitjes së policave të sigurimit të detyrueshëm motorik.

Zj. Makbule Hoxha është licencuar nga Bordi i AMF-së me Vendimin nr. 65, datë 26.05.2017 “Për miratimin e agjentëve në sigurime, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a.

Nga i shqyrtimi i materialeve të depozituara, si dhe verifikimi në regjistrin elektronik online të shitjes pranë Autoritetit, të kopjeve të policave të lëshuara me numër serie 180011402, me numër serie 180141250, me numër serie 180010133 dhe me numër serie 180010017, rezultoi se:

- Kodi i raportimit në policë është i ndryshëm nga ai që është gjeneruar nga regjistri elektronik online për atë police. (Për të katërta policat).
- Periudha e mbulimit në policë është e ndryshme nga periudha e mbulimit në regjistër. (Për tre polica).

- Data e lëshimit të policës në fakt ndryshon nga data e policës së hedhur në regjistër. (Për katër polica).

Agjenti ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 23, datë 26.02.2018 “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik”.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Bazuar në pikën 6, të nenit 199, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, për agjentin në sigurime zj. Makbule Hoxha, licencuar me Vendim Bordi nr. 65, datë 26.05.2017, të pezullohet ushtrimi i veprimtarisë për shitjen e policave të sigurimit për një periudhë prej 6-muaj.**
- 2. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI